



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:070694
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05759959

KPPP.nr.2014/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “BRUPHARM” Sh.A., me NUI:810010166, me seli në Fushë Kosovë, Rr. “Nëna Terezë” H-I-Nr.3, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokatura Zabeli & Sinani me seli në Prishtinë Rr.“Muhamet Qana” H-1, nr.5., kundër debitorit Barnatorja “Blerta Pharm” me NUI:810777899, me seli në Podujevë Rr.”20 Qershori” nr.5, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.47/22 të datës 17.03.2022, të Përmbartuesit Privat Fadil I. Hoxha nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 30.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Barnatorja “Blerta Pharm” me NUI:810777899, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.47/22 i datës 24.05.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.47/22 i datës 17.03.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha.
- III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në shumë prej 295.54 €.
- IV. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

1 (6)

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “BRUPHARM” Sh.A., me NUI:810010166, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.47/22 të datës 17.03.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Fatura me numër 3108/22 e datës 03.03.2022; fatura me numër 761/22 e datës 17.01.2022; fatura me numër 197/22 e datës 06.01.2022; fatura me numër 17537/21 e datës 10.12.2021; fatura me numër 15642/21 e datës 05.11.2021; fatura me numër 14564/21 e datës dt.15.10.2021; fatura me numër 14278/21 e datës 08.10.2021; fatura me numër 1356/21 e datës 22.09.2021; fatura me numër 13473/21 e datës 17.09.2021; fatura me numër 12444/21 e datës 27.08.2021; fatura me numër 10716/21 e datës 29.07.2021; fatura me numër 8188/21 e datës 11.06.2021; fatura me numër 8902/21 e datës 25.06.2021; fatura me numër 4885/21 e datës 08.04.2021; fatura me numër 4530/21 e datës 01.04.2021; fatura me numër 4189/21 e datës 25.03.2021; fatura me numër 3396/21 e datës 11.03.2021; fatura me numër 12857/20 e datës 04.12.2020; fatura me numër 12486/21 e datës 25.11.2020; fatura me numër 9456/20 e datës 10.09.2020; fatura me numër 7671/20 e datës 29.07.2020; fatura me numër 6911/20 e datës 08.07.2020; fatura me numër 6106/20 e datës 17.06.2020; fatura me numër 5091/20 e datës 14.05.2020; fatura me numër 4826/20 e datës 04.05.2020; fatura me numër 4777/20 e datës 29.04.2020; fatura me numër 4160/20 e datës 07.04.2020; fatura me numër 3946/20 e datës 31.03.2020; fatura me numër 3619/20 e datës 18.03.2020; fatura me numër 3240/20 e datës 11.03.2020; fatura me numër 1902/20 e datës 12.02.2020; fatura me numër 1340/20 e datës 30.01.2020; fatura me numër 13713/19 e datës 20.12.2019; fatura me numër 4993/19 e datës 09.05.2019; fatura me numër 1016/20 e datës 24.01.2020; fatura me numër 678/20 e datës 17.01.2020; fatura me numër 343/20 e datës 10.01.2020; fatura me numër 5954/21 e datës 29.04.2021; fatura me numër 4721/18 e datës 01.10.2018; fatura me numër 3840/18 e datës 03.09.2018; fatura me numër 3841/18 e datës 03.09.2018; fatura me numër 3609/18 e datës 27.08.2018; fatura me numër 3417/18 e datës 20.08.2018; fatura me numër 3400/18 e datës 18.08.2018; fatura me numër 3189/17 e datës 13.08.2018; fatura me numër 3007/18 e datës 07.08.2018; fatura me numër 2938/18 e datës 04.08.2018; fatura me numër 2712/18 e datës 30.07.2018; fatura me numër 2490/18 e datës 23.07.2018; fatura me numër 2070/18 e datës 09.07.2018; fatura me numër 1640/18 e datës 25.06.2018; fatura me numër 1387/18 e datës 13.06.2018; Fatura me numër 1225/18 e datës 07.06.2018; fatura me numër 1015/18 e datës 25.05.2018; Fatura me numër 813/18 e datës 15.02.2018; fatura me numër 12584/19 e datës 20.11.2019; fatura me numër 11930/19 e datës 04.11.2019; fatura me numër 11521/19 e datës 21.10.2019; fatura me numër 11460/19 e datës

21.10.2019; fatura me numër 11019/19 e datës 07.10.2019; fatura me numër 10355/19 e datës 24.09.2019; fatura me numër 5029/19 e datës 09.05.2019; Fatura me numër 3348/19 e datës 28.03.2019; fatura me numër 2768/19 e datës 14.03.2019; fatura me numër 2368/19 e datës 08.03.2019; fatura me numër 2270/19 e datës 05.03.2019; fatura me numër 2067/19 e datës 28.02.2019; fatura me numër 1502/19 e datës 15.02.2019; fatura me numër 888/19 e datës 31.01.2019; fatura me numër 780/19 e datës 25.01.2019; fatura me numër 279/19 e datës 11.01.2019 fatura me numër 7641/18 e datës 24.12.2018; fatura me numër 7229/18 e datës 13.12.2018; fatura me numër 6755/18 e datës 30.11.2018; fatura me numër 6458/18 e datës 19.11.2018; fatura me numër 6169/18 e datës 12.11.2018; fatura me numër 5449/18 e datës 22.10.2018; fatura me numër 5429/18 e datës 20.10.2018; fatura me numër 4962/18 e datës 08.10.2018; fatura me numër 4889/18 e datës 05.10.2018; fatura me numër 4774/18 e datës 02.10.2018; Note krediti nr.6/19 e datës 31.01.2019; fatura me numër 162/18 e datës 30.11.2018; fatura me numër 110/18 e datës 31.10.2018; fatura me numër 25/18 e datës 31.08.2018; fatura me numër 48/18 e datës 30.09.2018; fatura me numër 75/17 e datës 18.10.2017; fatura me numër 131/18 e datës 01.02.2018; fatura me numër 361/17 e datës 18.12.2017, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t'ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të mbetur sipas faturave të lartcekura në shumë prej 295.54 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e arritjes për pagesë, dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, ndër të tjerash ka theksuar se kreditori në përpjekje për të përfituar jashtëligjshëm ka grumbulluar një mori dokumentesh, i ka ndërlidhur me një analitik e cila prapë nuk përputhet me propozimin, numrat e faturave janë të gabuara. Ka shtuar se pagesat e debitorit për kreditorin bazuar në paragonet e përdorura nga kreditori si dëftesa dhe mandatet e arkëtimit del se debitori ka paguar më tepër për kreditorin vlerën prej 70.36 euro. Tutje ka theksuar se vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin përbarimor dhe se lejimi i propozimit bazuar në këso dokumente krejtësisht të pa besueshme e konsideron dëmtim të reputacionit për debitorin. Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin si të bazuar, të anulohet urdhri përbarimor dhe të hudhet si i kundërligjshëm propozimi.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet si të pa bazuara, ndër të tjerash ka theksuar se prapësimi është paraqitur me qëllimin e vetëm të prolongimit të procedurës përmbartimore dhe se me debitorin që nga viti 2017 janë në raporte kontraktuale ku debitori është furnizuar me produkte të ndryshme nga kreditori, gjatë kësaj kohe debitori ka realizuar pagesa të ndryshme në formë të këstit e në raste të caktuara ka pas edhe kthime të mallit ku pastaj të dy palët kanë barazuar. Ka shtuar se sa i përket pretendimit se debitori ka paguar më tepër vlerën prej 70.36 euro, është një absurditet i llojit të vet, sepse debitori nuk ka asnjë mundësi që ta vërtetoj me prova konkrete dhe të ligjshme. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit, dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura, në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm respektivisht faturat e lartcekura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të

besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, dhe është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi dhe vula e debitorit si dhe fakti që faturat nuk janë kontestuar asnjëherë nga ana e debitorit.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarimore.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, në afatin prej 7 ditëve, në momentin e parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar nga gjykata si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, Gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se urdhri për përmbarim i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2014/22, datë 30.05.2024

Gjyqtari

Gent Bkeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.